REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA ANONIME : "Ujësjellës -Kanalizime" SH.A Vlorë
NIPT-i : K07303204A

Adresa Kryesore e Selisë : Lagjia "28 Nëntori" , Rruga "Arkobaleno" Vlorë

Vlorë , më 29 Qershor 2012

VENDIM I ASAMBLESË TË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË .

Sot më datën 29 Qershor 2012 në mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë "Ujësjellës -Kanalizime" SH.A Vlorë e përbërë nga :

Bashkia Vlorë	Etjona Hoxha	
Bashkia Himarë	Stefo Kokëdhima	
Komuna Shushicë	FATOSH DANAJ	
Komuna Armen	Dëfrim Hoxha	
Komuna Kotë	Gazment Muho	
Komuna Qendër	ALDO AVDULLAI	

Në përfundim të mbledhjes

VENDOSËM :

1- Të miratojmë ndryshimet në Statutin e shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime" sh.a Vlorë në përshtatje me ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" .

2- Për aplikimin e këtij vendimi në QKR ngarkojmë znj Eglantina Ajdini .

Për shoqërinë "Ujësjellës – Kanalizime" sh.a Vlorë (kryetarët e këshillave)

Aksionerët

Bashkia Vlorë	Etjona Hoxha	
Bashkia Himarë	Stefo Kokëdhima	
Komuna Shushicë	FATOSH DANAJ	
Komuna Armen	Dëfrim Hoxha	
Komuna Kotë	Gazment Muho	
Komuna Qendër	ALDO AVDULLAI	

AKT -THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 18.06.2001 ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1.Te krijoje shoqerine anonime" Ujesjellesi " Vlore

2. Objekti I shoqerise eshte:
Prodhim dhe shperndarje e ujit te pishem per rrethin e Vlores.

3.Shoqeria do te kete seline e saj ne Vlore dhe ajo mund te çele dege, filiale, agjenci dhe perfaqesi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.

4. Kapitali themeltar eshte 586.631.000 leke ndare ne 586.631 aksione me vlere nominale 1000 leke.

5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
Z. Arben Skenderi
Znj.Marije Beqiri
Z. Dule Harizaj

7. Ndertimi, organizimi dhe fuksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

KRYEMINISTRI

PAJTIM BELLO

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE DHE E PRIVATIZIMIT TIRANE

S T A T U T

I
SHOQERISE ANONIME

NENI 1
Emertimi dhe selia

Shoqeria anonime krijohet nga transformimi I ndermarrjes shteterore Ujesjelles Vlore.
Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet: Sh.A Ujesjelles Vlore.

Selia e shoqerise eshte ne adrese : Vlore.

NENI 2
Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:
Prodhim dhe shperndarje e ujit te pishem per rrethin e Vlores.
Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera jashte vendit.

NEN3
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar I shoqerise 586.631.000.leke. Numri i aksioneve eshte 586.631 Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke.Ne kapitalin themeltar eshte perfshire edhe trualli me vlere 14.043.120. leke.

NENI 4
Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me Urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

NENI 5
Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1) Keshilli mbikqyres
2) Drejtoria

NENI 6
Keshilli Mbikqyres

- Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Priatizimit.
- Kohezgjatja e fuksionit te tyre eshte 4 (kater) vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
- Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit..
- Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 (gjashtedhjete e pese) vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

NENI 7
Kryetari dhe zevendeskryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar, te cilet therresin mbledhjen e keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithe kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.
Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij.
Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendeskryetari.

NENI 8
Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendeskryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesembedhjete) diteve kur drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere anetaret mund te therresin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke i percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat ne se anetaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate. Çdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.
Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.
Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari ose zevendeskryetari.
Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendeskryetari i keshillit mbikqyres.

NENI 9
Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli mbikqyres emeron drejtorine. Keshilli mbikqyres cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te statutit.
- Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrolle qe ia i çmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten njehere ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çeshtje :

a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.
b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
c) Hapjen e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
g) Si dhe per çdo çeshtje tjeter qe ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjitheshme

NENI 10
Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

NENI 11
Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithe anetareve te ketij keshilli.
- Anetaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar drejtore ose drejtor ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga fuksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 4 (kater) vjetesh. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura, keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhjete e pese) vjeç. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhje e pese) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

NENI 12
Kompetencat e drejtorise

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.

- Ne marredheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruara nga anetari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin e veprimtarise se shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise kapercente objektin e veprimtarise se shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke pasur parsysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.
- Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga anetari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e anetareve te saje. Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlere mbi 2 (dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- .Marredheniet brenda shoqerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga keshilli mbikqyres.

Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton keshilli mbikqyres.

NENI 13

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetereve te drejtorise ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejteperdrejte ose jo e drejteperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet mareveshje. Kjo nuk eshte e zbatueshme per mareveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.

Anetari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesat e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 14
Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga 1,(nje) eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

NENI 15
Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

NENI 16
Inventari -llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitetit te rregullt te pasurise dhe te vperimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbylljen te ushtrimit, drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 17
Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem.
Nga fitimet e ushtrimit, te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme.
Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsye çfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit.
Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

NENI 18

Emerimi i anetareve te pare te keshillit mbikqyres

Si anetare te pare te keshillit mbikqyres

Z Arben Skenderi

Zj. Marije Beqiri

Z. Dule Harizaj

NENI 19

Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Ekspert i (te) pare kontabel i (te) autorizuar emerohet (n)

Z . Namik Veipi.

NENI 20

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine aksionerit te vetem.

NENI 21

Dispozita te fundit

Ne nje afat prej 6(gjashte) muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar drejtori I shoqerise do te jete drejtori I ish-shteterore.Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit.vec per shkaqe te perligjura.

NENI 22

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE DHE PRIVATIZIMIT TIRANE

KRYEMINISTRI

Fatim BELLO

S T A T U T I

I SHOQËRISË ANONIME

"UJËSJELLËS - KANALIZIME" SH.A. Vlorë

Sot më datën 29 Qershor 2012 themeluesit e shoqërisë anonime **"Ujësjellës - Kanalizime" SH.A. Vlorë** kryen ndryshimet në statutin e kësaj shoqërie në përshtatje me ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe e pasi morëm vendim për miratimin e këtyre ndryshimeve e paraqes atë për regjistrim në QKR me kushtet e mëposhtëme :

KREU I
OBJEKTI I VEPRIMTARISË , SELIA E SHOQËRISE , KOHËZGJATJA

Neni 1
BAZUESHMËRIA JURIDIKE

Veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvilloj në përshtatje me ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përshtatje me të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi .

Neni 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria tregtare **"Ujësjellës - Kanalizime" SH.A. Vlorë** ka për objekt të veprimtarisë së saj :

1-Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij .
2-Mirëmbajtja e sistemit (eve) të furnizimit me ujë të pijshëm .
3-Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve .
4-Shërbimi i grumbullimit , largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura dhe shitja e tij .
5-Mirëmbajtja e sistemeve te ujrave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre .

Shoqëria mundet të realizoj çdo lloj operacioni tregtar e financiar që lidhet direct apo indirect me objektin e saj , Brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
Shoqëria do të kryej çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve , autorizimeve , liçencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimeve të saj për të cilat kërkohen këto dokumenta administrative .

Neni 3

VENDODHJA E SELISË SË SHOQËRISË .

Selia e shoqërisë është caktuar në qytetin e Vlorës në lagjen "28 Nëntori" , Rruga "Arkobaleno" . Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një vendimi të Asamblesë së Aksionerëve.

Neni 4 .
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË .

Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat të caktuar .Shkurtimi i kësaj kohëzgjatjeje në rastin e një prishje të parakohëshme ose zgjatje të afatit bëhen me vendim të Asamblesë së Aksionerëve .

KREU II.
KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Neni 5 .

KONTRIBUTET NË KAPITAL .

Në momentin e themelimit , shoqërisë i janë sjell si kontribut në para një shumë prej 586.631.000 (pesëqindetetëdhjetëe gjashtë e gjashtëqinde tridhjetë e një mijë) lekë dhe është i ndarë në 586.631 aksione me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secili , të gjitha në para që përbëjnë kapitalin fillestar të shoqërisë dhe shtesat në kapitale të vlerësuara nga ekspertët në bazë të raportit të ekspertëve kontabël . Aksionet janë të pandashme . Këto aksione janë nënshkruar tërësisht .

Neni 6 .

AKSIONET

Aksionet janë të formës nominale dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi .

Aksionet zotërohen nga :

Bashkia Vlorë	70.6 %
Bashkia Himarë	6.4 %
Komuna Shushicë	5 %
Komuna Armen	4.3 %
Komuna Kotë	4 %
Komuna Qendër	9.7 %

Neni 7

Aksionet janë të tregëtueshme vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithëshme të Aksionerëve .

Neni 8 .

Me përjashtim të rasteve të Trashëgimisë , aksionet tregtohen brenda shoqërisë duke iu shpërndarë askionerëve të tjerë në pjesë të barabarta për të ruajtur raportet .

Në të gjitha rastet kur bëhet blerja e tyre nga aksionerët e tjerë të shoqërisë , vlerësimi i aksioneve do të behet nga një ekspert i cili caktohet me mirëkuptim nga palët .

Në raste se nuk bihet dakort ai caktohet me vendim të Gjykatës , ndryshimi I pronësisë së aksioneve si rrjedhojë e një shitjeje ose transferimi bëhet në bazë të një urdhëri kalimi në regjistër .

Neni 9 .

Transferimi i pronësisë mbi aksionet tek një person jo aksionar , kur nuk realizohet tregtimi sipas nenit 8 të këtij Statuti , pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi , duhet të miratohet me konsesus nga Keshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Përgjithëshme e Aksionerëve .

Neni 10 .

Aksionet janë të pandashme kundrejt shoqërisë e cila njeh vetëm një pronar kryesor të një aksioni . Çdo aksion I jep të drejtën e një vote . Një aksion nuk mund të ketë më shumë se një zotërues .

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm pronësi i tij i ligjshëm .

Aksionerët janë përgjegjës deri në kufirin e vlerës minimale të aksioneve që zotërojnë .

Çdo kërkim fondesh përtej këtij kufiri është i ndaluar .

Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e marrjes së një pjese nga fitimiet e shoqërisë në përpjestim me kuotën – pjesë të kapitalit që ai përfaqëson , si dhe i jep zotëruesit të tij të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Asamblenë e Përgjithëshme .

Aksioneret ushtrojnë të drejtat e tyre përsa i përket Drejtorit të Shoqërisë Anonime nëpërmjet Asamblesë të Përgjithëshme të Aksionerëve .

Neni 11 .

NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

A)ZMADHIMI I KAPITALIT .

Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Aksionerëve të statutit në bazë të raportit të Drejtorit të Ekspertit kontabël .

Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet :

1.Emetimit të aksioneve të reja ose :

2.Rritjes së vlerës nominale të aksioneve egzistuese .

Aksionet e reja shlyhen me para në dorë . aksioneri ka të drejtë përparësie në nënshkrimin për rritjen e kapitalit me para në dorë propocionalishtme shumën e aksioneve që zotëron , çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme .

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet realizuar brenda 5 viteve nga dita që Asamblesë së Aksionerëve ka miratuar këtë zmadhim të kapitalit .

B)ZVOGËLIMI I KAPITALIT .

Zvogëlimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga Asamblesë së Aksionerëve në mbledhjen e saj . Në Asamblesë së Aksionerëve që thirret për zvogëlim të kapitalit dorëzohet raporti i arsyetuar i Drejtorit , duke shpjeguar arsyet që bëjnë të detyrueshme marrjen e vendimit përkatës .

Në të gjitha rastet , zvogëlimi prej aksionerëve në të njëjtën masë , në përpjestim me vlerën e aksioneve qe zotërojnë .

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Aksionerëve që thirret për të vendosur mbi këtë projekt .

Neni 12 .

SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT .

Nuk mund të merret vendim dhe të realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para në dorë nëse kapitali aksionar i deritanishëm nuk është shlyer plotësisht .

Në rast të kundërt operacioni i zmadhimit të kapitalit dhe lëshimi i aksioneve të reja konsiderohet i pavlefshëm .

Këshilli mbikqyrës në çdo rast të zmadhimit të kapitalit duhet që në një afat 3 mujor nga realizimi i zmadhimit të kapitalit të verifikojë depozitimin e kapitalit .

Nëse kapitali nuk është mbuluar plotësisht atëhere Keshilli Mbikqyrës disponon lirshëm aksionet e pambuluara tek të tretët ose kapitali aksionar shtohet deri ne shumën e mbulimit tëqt tij .

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

Shoqëria Anonime **"Ujësjellës – Kanalizime" Sh.A Vlorë** drejtohet , organizohet dhe administrohet nga organet e tij që janë Këshilli Mbiqyrës dhe Drejtoria .

Neni 13

KOPETENCAT E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Këshilli Mbikqyrës ushtron kontroll të përhershëm dhe të vazhdueshëm ndaj Drejtorit dhe anëtarëve të tjerë të drejtorisë për drejtimin dhe administrimin e shoqërisë nga ana e tij .

Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të kryeje ne çdo kohë të vitit verifikimet dhe kontrollet që ai i çmon te arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentat që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij .

Këshilli Mbikqyrës vendos për operacionet që do të kryhen me autorizimin e tij nga Drejtoria .

Këshilli Mbikqyrës miraton strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet e saj , kriteret e punësimit dhe te pagave si dhe rregulloren e brendëshme të shoqërisë .

Drejtori i paraqet raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në 3 muaj .

Brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar , Drejtori I paraqet Këshillit Mbikqyrës dokumentat që përcaktohen sipas ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me qëllim verifikim dhe kontroll .

Këshilli Mbikqyres në përputhje me ligjin Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" , i paraqet Asamblesë vërejtjet e tij mbi raportin e Drejtorisë , si dhe atom bi llogaritë e vitit financiar .

Neni 14 .

PËRBËRJA

Këshilli Mbikqyrës , përbëhet nga 6 anëtarë . Asnjë anëtar i Këshillit Mbikqyrës nuk mund të jetë drejtor i shoqërisë . Në rast se një anëtar i Keshillit Mbikqyrës emërohet drejtor , atëhere mandati i tij në Këshillin Mbikqyrës përfundon sapo ai të kaloj në funksionin e ri .

Neni 15

EMËRIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKQYRËS DHE KOHËZGJATJA .

Asambleja e Pergjitheshme cakton 3 ose me shume , por jo me shume se 21 persona fizike si anetare te keshillit mbikqyres ne pajtim me shkronjen "c" te nenit 135 dhe pikes 2 te nenit 155 te ligjit . Emerimet do te jene individuale dhe ne perputhje me vendimin e asamblese se pergjitheshme te marre me shumice votash , i cili , nese miratoher , sjell emerimin e anetarit te propozuar si anetar te keshillit mbikqyres . Anetaret e Keshillit mbikqyres mund te shkarkohen nga detyrat ne cdo kohe nga asambleja e pergjitheshme pa cenuar te drejtat qe lindin nga nje kontrate pune te lidhur me shoqerine .

Anetaret e Keshillit Mbikqyres do te jene te pavarur dhe nuk do te jene Administratore , ne perputhje me parashikimet e pikes 1 dhe 4 te nenit 155 te ligjit .

Neni 16

KRYETARI DHE ZV/KRYETARI I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Këshilli mbikqyrës zgjedh nga gjiri i tij një Kryetar dhe një Zëvendës Kryetar që ngarkohen me , mbledhjen e Keshillit dhe drejtimin e debatit gjatë seancave të tij .

Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë gjithë periudhës së mandatit të Keshillit Mbikqyrës .

DREJTORIA

Neni 17

EMËRTIMI

"Ujësjellës – Kanalizime" Sh.A Vlorë drejtohet nga Drejtoria e cila ushtron funksionet e saj nën kontrollin e Këshillit Mbikqyrës .

Emërimi i Drejtorit bëhet nga Këshilli Mbikqyrës .

Drejtori është person fizik , në të kundërtën emërimi i tij është i pavlefshem .

Këshilli mbikqyrës mund të zgjedh drejtorin dhe anëtarët e drejtorisë dhe jashtë grupit të aksionerëve .

Drejtori i përgjithshëm i **"Ujësjellës – Kanalizime" Sh.A Vlorë** është **Varvara Gjika** .

Neni 18 .

SHKARKIMI I DREJTORIT DHE ANËTARËVE TË DREJTORISË

Drejtori dhe anëtarët e drejtorisë mund të shkarkohen për shkaqe të përligjura nga Këshilli mbikqyrës sipas ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" .

Si shkaqe të përligjura konsiderohen veçanërisht fajet e rënda të drejtorit dhe të anëtarëve të drejtorisë , si pa aftësia e tyre në kryerjen korrekte të funksioneve , kur Asambleja humbet besimin te kjo drejtori si dhe kur dëmtohen interest e shoqërise .

Përjashtohen rastet kur shkarkimi është i nxitur hapatzi nga shkaqet që nuk kanë të bëjnë me interesat e shoqërisë .

Shkarkimi mbetet në fuqi derisa vendimi gjyqësor që evidenton pavlefshmërinë e shkarkimit të marrë fuqi ligjore .

Neni 19

PËRBËRJA, TË DREJTAT E DETYRIMET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS DHE ADMINISTRATORËT .

1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, shkronjat "b" deri në "g" e "i" dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji.

2. Në bazë të parashikimeve të statutit, administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 158 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës. Së bashku me funksionet e pikave 3, 4 e 5 të nenit 158 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", administratorët kanë të drejtë e duhet të kryejnë edhe funksionet e përcaktuara në shkronjat "a", "gj", "h" e "i" të pikës 1 të nenit 154 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare". Me përjashtim të rastit të parashikuat nga neni 13 dhe nga shkronja "e" e pikës 1 të nenit 154 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", veprimet e administratorëve u nënshtrohen miratimit nga këshilli mbikëqyrës vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut.

3. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të këshillit mbikëqyrës administratorët e shoqërisë administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 13 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare".

Neni 20

SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TE DREJTORISË .

Mënyra dhe masa e shpërblimit të secilit anëtar të drejtorisë caktohet në keshillin Mbikqyrës në aktin e emërimit .

Neni 21 .

TË DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, e në veçanti nga dispozitat e nenit 148 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" , të drejtat e aksionarëve , për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) përcaktimin e politikave tregtare;

b) ndryshime të statutit;

c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës e, kur parashikohet në statut, emërimin dhe revokimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;

dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;

gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;

h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

4. Të gjitha vendimet e marra nga aksionarët e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;

c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;

ç) vendimet për investime;

d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

ASAMBLEJA E AKSIONERËVE

Neni 23 .

Asamblea e Aksionerëve është organi më i lartë i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje .

Vendimet e Asamblesë së Aksionerëve janë angazhuese për aksionerët .

Vetëm Asambleja e Aksionerëve ka të drejtën e ndryshimit të Statutit në lidhje me të gjitha dispozitat e tij .

Çdo kusht tjetër konsiderohet i pavlefshëm .

Vendimet e Asamblesë se Aksionerëve merren me shumicën e ¾ e votave të përfaqësuara të aksioneve .

Neni 24

Asambleja e Aksionerëve merr çdo vendim , perveç atyrë që parashikohen ndryshe në ligjin Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Aksionerëve merr vendim në mënyrë vendimore për te gjitha çështjet që kanë të bëjne me shoqërinë .

Asambleja e Aksionerëve mblidhet një herë në vit ose brenda 6 mujorit pas mbarimit te vitit financiar .

Asambleja Aksionerëve shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet e vitit financiar që mbyll , ajo ushtron kopetencat që ka në bazë të ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 25

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME DHE RENDI I DITËS, I KËRKUAR NGA AKSIONARËT E PAKICËS .

1. Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruartë shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare".

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

Neni 26

Çdo aksioner mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjeter ose nga e shoqja/1 shoqi .
Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës dhe të Drejtorisë kur janë aksioner marrin pjesë me veto vendimore

Çdo aksioner ka të drejtë të informohet për të gjitha çështjet që parashikohen ne ligjin Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR .

Neni 27

Auditimi i shoqërisë ushtrohet nga një ekspert kontabël i autorizuar i cili emërohet për 3 vjet në pajtim me shkronjen "ç" , pika 2 , neni 135 i ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Gjatë mandatit të tyre , eksertet kontabël të miratuar mund të largohen nga puna vetëm për shkaqe të arsyeshme . Mendimet e ndryshme për metodat e kontabilitetit apo proçedurat e kontrollit nuk përbëjnë shkaqe të arsyeshme për largimin e ekspertëve kontabel të autorizuar .

KREU IV
AUDITIMI I SHOQËRISË

Neni 28

Asambleja e Përgjithshme do të emëroj një Auditues i cili ka cilësinë e ekspertit kontabël të miratuar dhe e ngarkon me keto detyra :
- Mbajtjen e llogarive të shoqërisë në mënyrë që ato në jenë sipas parimeve bazë të kontabilitetit
- Përgatit raportin vjetor të të dhënave ekonomike dhe shpreh mendimin nëse të dhënat ekonomiko – financiare reflektojnë realitetin e gjendjes ekonomike financiare të shoqërisë .
- Informon Këshillin Mbikqyrës në lidhje me ndonjë parregullsi të mundëshme që vihet në shkëmbime , proçedura , active ose llogaritë e shoqërisë të cilat mund të çonin në egzistencën e humbjeve për shoqërinë .

Neni 29

Audituesit e autorizuar kanë për detyrë të mbikqyrin llogaritë vjetore të cilat duhet të jenë përpiluar në bazë të ligjit "Për Kontabilitetin" dhe të shprehin me saktësi rezultatet e periudhës ushtrimore si dhe të japin me sinqeritet dhe rezultatin e dalë në fund të vitit financiar .

Neni 30

Në fund të çdo viti financiar Këshilli Mbikqyrës bën regjistrimin (Inventarin) e llogarive vjetore në bazë të dispozitave të ligjit "Për Kontabilitetin" si dhe përpilon raportin për administrimin e tyre .

KREU V

REZERVAT E DOMOSDOSHME , NDARJA E FITIMEVE , DIVIDENTËT .

Neni 31

Kapitali rezervë krijohet në masën 5 % të fitimit neto pasi më përpara të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme .

Neni 32

Fitimet që do të ndahen përbëjnë fitimet e bilançit mbasi të jenë zbritur rezervat dhe hubjet e mundëshme të viteve të kaluara në bazën edhe të nenit më sipër .

Neni 33

Mbas miratimit të bilançit vjetor dhe regjistrimin e shumës që do të ndahet , Asambleja e Përgjithshme përcakton Shumen që do të ndahet tek aksionerët në formën e dividentëve .

KREU VI
PRISHJA E SHOQËRISË .

Neni 34

Shpallet në mbledhjen e Asamblesë së Aksionereve .
Shoqëria prishet automatikisht me mbarimin e afatit sipas Statutit .
Shoqëria mund të mbyll aktivitetin e saj para afatit të caktuar në kontratë , kur :

a)Aksionerët vendosin me marrveshje për mbyllje .
b)Aktiviteti rezulton me humbje për një periudhë për tre vjet të njëpasnjëshëm .
c)Kur kapitalet e veta bëhen më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar .

Në rast të mbylljes së aktivitetit në çdo kohë ose për çdo arsye Asambleja e Aksionerëve cakton mënyrën e likujdimit dhe emëron një ose më shumë likujdator duke përcaktuar fuqitë dhe kopetencat .

Likujdimi i shoqërisë bëhet në bazë të dispozitave që përcaktohen nga ligji .

Neni 35 .

DISPOZITAT E FUNDIT

Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut dhe gjatë themelimit të shoqërisë zbatohen dispozitat në fuqi të ligjit "Për Shoqëritë Anonime pa ofertë publike"

AKSIONERËT THEMELUES

Bashkia Vlorë	Edjona Hoxha
Bashkia Himarë	Stefo Kokëdhima
Komuna Shushicë	Fatosh Danaj
Komuna Armen	Bëfrim Hoxhaj
Komuna Kotë	Gazmend Huka
Komuna Qendër	Aldo Avdulaj

325
28.07.2016

ujesjellesi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I ADMINISTRIMIT
SH.A UJESJELLESI VLORE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421-215; Fax 033 421-201; E-mail: info@vlora.gov.al

Nr 6132 prot.

Vlore, me 21.07 2016

V E N D I M
Nr. 35 Dt. 21.07 2016

" Per miratimin e statutit te SH.A Ujesjellesit Vlore "

Bazuar ne Ligjin nr.9901, dt.14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", neni 135, pika 2/b, ne VKM nr. 63, dt.27.01.2016, " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura", ne Statutin tip te miratuar me VKM nr. 63, dt.27.01.2016, " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura":

V E N D O S A:

1. Te miratoj statutin e SH.A Ujesjellesit Vlore sipas formulimit te statutit tip te miratuar me VKM nr. 63, dt.27.01.2016, " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura"
2. Te gjitha procedurat per organizimin dhe funksionimin e SH.A Ujesjellesit Vlore si dhe zgjedhja, emerimi , komptencat dhe funksionet e organeve drejtuese te SH.A. Ujesjellesit te rregullohen sipas statutit tip te miratuar me VKM nr. 63, dt.27.01.2016, " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura"
3. Statuti aktual i SH.A Ujesjellesit Vlore revokohet
4. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere

Per asmblene e aksionereve
Dritan LELI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KR. BASHKIA VLORE

LOI ORGANIQUE

portant statut général des agents publics civils et militaires

Le Président de la République du Niger

Vu la Constitution du 18 juillet 2010 ;

Vu la décision n° 2010-01/ PCSC du 20 août 2010 portant promulgation de la Charte de la Transition ;

Vu le décret n° 2010-001/ PCSC du 22 août 2010 portant composition du Gouvernement de la Transition ;

Vu le décret n° 2010-002/ PCSC du 22 août 2010 portant nomination du Premier Ministre ;

Vu le décret n° 2010-003/ PCSC du 22 août 2010 portant nomination de membres du Gouvernement de la Transition ;

Vu le décret n° 2010-004/ PCSC du 22 août 2010 portant nomination de membres du Gouvernement de la Transition ;

Vu le décret n° 2010-005/ PCSC du 22 août 2010 portant nomination de membres du Gouvernement de la Transition ;

Vu le décret n°